



Planuar / Dorezuar Prilideno/Prodato Received/Delivry	24.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMISHCK	3010/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.Nr.395/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.395/2022 të datës 19.04.2022 të parashtruar nga ankuesi Besart Tasholli me përfaqësuese juridike avokate me adresë kundër organit të punësimit Agjencia e Kosovës për Akreditim, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.395/2022 e datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes avokates

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “ Zyrtar për Personel” në Qendrën e Studentëve, nëpërmjet përfaqësueses së tij me autorizim më datë 19.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër njoftimit të datës 30.03.2022 për rezultatet e konkursit dhe se organi i punësimit Komisioni i Rekrutimit i MASHITI-it ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike dhe ka shkelur dispozitat procedurale lidhur me procedurën e rekrutimit të parashikuar me Ligjin për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.16/2020 për pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe propozon që të anulohet.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2022 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Agjencia e Kosovës për Akreditim për përgjigje në ankesë. Më datë 11.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Kosovës për Akreditim me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokollin 2195/2022 të datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 01.04.2022 nga _____ për avokaten _____ E-mail nga B.T. për L.L. i datës 19.04.2022; E-mail nga B.T. për B.J. i datës 07.04.2022; Ankesë për Komisionin e Ankesave (AKA) dhe Komisionin e Rekrutimit me numër 381/22 i datës 30.03.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 11.05.2022; Konkurs i datës 10.02.2022; Lista e Aplikantëve simbnj; Aplikacioni i B.T. i datës 25.02.2022; Akt Emërim i B.T. i datës 11.10.2018; Aplikacioni i F.S. i datës 02.03.2022; Aplikacioni i A.B. i datës 03.03.2022; Vendim me nr.310/22 i datës 09.03.2022; Formular Vlerësimi Verifikimi paraprak nga NjBNj i datës 10.03.2022; E-mail nga B.J. për B.T. i datës 10.03.2022; E-mail nga F.SH. për B.J. i datës 10.03.2022; E-mail nga A.B. për B.J. i datës 10.03.2022; Formulari Individual i Vlerësimit i datës 14.03.2022; Formulari Individual i Vlerësimit i datës 14.03.2022; Formulari Individual i Vlerësimit i datës 14.03.2022; Formulari Individual i Vlerësimit i datës 14.03.2022; Formulari Individual i Vlerësimit i datës 14.03.2022; Formulari i Vlerësimit Përfundimtar i datës 14.03.2022; Renditja Përfundimtare e Kandidatëve i datës 14.03.2022; E-mail nga B.J. për B.T. i datës 30.03.2022; E-mail nga B.J. për A.B. i datës 30.03.2022; Vendim me Nr.437/22 i datës 06.04.2022; E-mail nga E.B. për N.G. i datës 13.04.2022; E-mail nga B.T. për A.K. i datës 08.04.2022; Kërkesë për qasje në dokumente publike i datës 21.04.2022; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil të Qendrës së Studentëve B.T. me numër protokollin 536/22 i datës 26.04.2022; Përgjigje në kërkesë për Drejtorin e AKA-së me numër protokollin 550/22 i datës 27.04.2022; E-mail nga B.T. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 18.05.2022; Kërkesë me numër protokollin 2890/2022 i datës 18.05.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar së ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit _____ **sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi _____ nëpërmjet përfaqësueses së tij me autorizim më datë 19.04.2022 me numër protokollin 2195/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër njoftimit të datës 30.03.2022 për rezultatet e konkursit dhe se organi i punësimit Komisioni i Rekrutimit i MASHTI-it ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike dhe ka shkelur dispozitat procedurale lidhur me procedurën e rekrutimit të parashikuar me Ligjin për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.16/2020 për pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe propozon që të anulohet, mirëpo ankuesi më datë 18.05.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokollin 2890/2022, për tërheqjen e ankesës së datës 19.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesi me kërkesën e datës 18.05.2022 ka tërhequr ankesën e datës 19.04.2022, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"**, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.




Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt, administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.395/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar të ankuesit avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

